



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 62, datë 22/12/2004

**“PËR
SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK
PËR VITIN 2004”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ligjit Nr.7776, dt.22/12/1993 “Për buxhetin lokal”, ndryshuar me ligjin Nr.8399, dt.09/09/1998, Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.16, dt.10/03/2004 “Për miratimin e realizimit të buxhetit për vitin 2003 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2004”, me rastin e festave të fundvitit, me propozimin e një grupi Këshilltarësh dhe Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë shpërblimin në masën 30.000 lekë për Këshilltarë, sipas listës bashkëngjitur.
2. Efektet financiare për zbatimin e pikës 1 të këtij Vendimi të përballohen nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, në artikullin 602 “Shpenzime operative” të Aparatit të Bashkisë së Tiranës, miratuar me buxhetin e vitit 2004.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI